



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË  
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE  
(Drejtore në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Korçë)**

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, të Vendimit nr. Nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të ndryshuar, Këshilli i Qarkut Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për pozicionin:

-1 (një) Drejtore në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Korçë  
-Kategoria IV-1

*Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!  
Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **lëvizje paralele** është data **28.02.2024**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **ngritje në detyrë** është data **06.03.2024**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

- Drejtori i DAMT-së përgjigjet para Këshillit të Qarkut dhe strukturave përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- DAMT përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e tokës bujqësore, si dhe të kategorive të tjera të resurseve të përcaktuara në ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të dispozitave vijuese të këtij vendimi, si dhe akteve të tjera nënligjore për administrimin e tokës.
- Rifreskon, administron dhe pasuron materialet arkivore (harta, libra ngastrash, etj) të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

- d) Drejtori i DAMT-së organizon punën dhe përgjigjet për kualifikimin tekniko-profesional të punonjësve të DAMT-së, nëpërmjet trajnimeve periodike të tyre dhe informimeve për standardet bashkëkohore në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës.
- e) Drejtori i DAMT-së, për realizimin e funksionit të saj si kadastrë e shumëqëllimshme, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues që disponohet pranë saj, pavarësisht nga koha e krijimit të tij.
- g) DAMT-ja bashkërendon veprimtaritë me zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në Njësi Administrative dhe/ose bashki, organizon punën për krijimin e dokumentacionit të kadastral për tokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të tjera, të përcaktuara me ligj.
- h) DAMT-ja bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për këmbimin e informacioneve, të treguesve dhe të të dhënave, që krijohen nga zbatimi i programeve dhe projekteve me objekt tokën bujqësore dhe çdo kategori të resurseve të tjera.
- i) Bazuar në dokumentacionin, aktet, treguesit dhe informacionet e marra nga institucionet kompetente, si dhe sipas informacioneve dhe të dhënave plotësuese, e institucioneve të tjera shtetërore, organizon punën për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën dhe integrimin gradual të tij në GIS, për të gjitha resurset që ka në administrim, brenda territorit të qarkut.
- j) Referuar pikës 4 të nenit 12 të ligjit Nr. 10257 datë 24.03.2010 specialisti i drejtorisë së administrimit dhe mbrojtjes së tokës, kryen shërbime dhe jep informacion në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni për sipërfaqen dhe vendndodhjen e ngastrave bazë të tokave.
- k) Bashkëpunon me Drejtorinë e Urbanistikës në bashki lidhur me vendimet e marra prej tyre për sheshe e leje ndërimi dhe pasqyron ndryshimet e zërit kadastral në dokumentacionin kadastral të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- l) Bashkëpunon me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, ASHK-në, njësitë e qeverisjes vendore, lidhur me ndryshimin e kategorisë së resurseve dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral duke mbajtur evidenca në arkivin e DAMT-së
- m) Bashkëpunon me ASHK-në lidhur me zërin kadastral të pasurive, përcaktimin e saktë të kufijve dhe problematikatë tjera të cilat hasen gjatë procedurës së regjistrimit.

## **1. LEVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori ekzekutive, në të gjithë institucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LEVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon**

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori IV-1
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat Agronomi, Gjeografi, Gjeodezi, Ekonomik dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune në profesion, nga të cilat 1 (një) vit në nivel të mesëm drejtues.
- Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese.



## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DOREZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Qarkut Korçë Brenda datës 28.02.2024 dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteskrimi-standard>
- b - Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.
- c - Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- d - Fotokopje të letërnyftimit (ID)
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori çirekt
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- i - Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, brenda datës 28.02.2024, në adresë: : Lagjia 7, Rruga "28 Nëntori", Korçë, Shqipëri*

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 01.03.2024 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Korçë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **1.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar
- b- Njohuri mbi Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar
- c- Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.
- d- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike"
- e- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"
- f- Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar
- g- Ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar
- gj- Ligjin Nr. 8053, date 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore".
- h- Ligjin Nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve"

- i- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar.
- j- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- k- Ligjin Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
- l- Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- m- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “ Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”.
- n- Vendim Nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish - kooperativave bujqësore” i ndryshuar.
- o- VKM Nr. 410, datë 02.07.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”. i ndryshuar.
- p- VKM Nr. 1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërbim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”.
- q- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.....”
- r- Vendim Nr. 222, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ishndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJEN PARALELE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) Për përvojën - deri 20 pikë;
  - b) Trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën - deri 10 pikë;
  - c) Çertifikimin /vlerësimet e fundit pozitive - deri 10 pikë
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>



## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Korçë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

## **2. NGRITJA NË DETYRË**

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizies paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më ulët), të punësuar në të njëjtin apo në institucione të tjera të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë të cilët plotësojnë kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” shkencat Agronomi, Gjeografi, Gjeodezi, Ekonomik dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në profesion, nga të cilat 1 (një) vit në nivel të ulët drejtues.
- c) Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit.
- d) Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Qarkut Korçë deri në datën 06.03.2024 dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Master)
- c - Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID)

- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
- h - Fotokopje të aktit të deklaramit të statusit
- i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi
- j - Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmënaura në jetëshkrim

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, brenda datës 06.03.2024, në adresë: : Lagjia 7, Rruga "28 Nëntori", Korçë, Shqipëri.*

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 18.03.2024, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Korçë ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Korçë për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adreses së e-mail).

### **2.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA.**

Kandidatet do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar
- b- Njohuri mbi Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar
- c- Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.
- d- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike"
- e- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
- f- Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar
- g- Ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar
- gj- Ligjin Nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore".
- h- Ligjin Nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve"
- i- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar.
- j- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar.
- k- Ligjin Nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
- l- Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.
- m- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki"
- n- Vendim Nr. 253, datë 6.3.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish - kooperativave bujqësore" i ndryshuar.



o- VKM Nr. 410, datë 02.07.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”. i ndryshuar.

p- VKM Nr. 1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”.

q- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Tjërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.....”

r- Vendim Nr. 222, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ishndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;
- b- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë
- c- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezulttit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

### **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).